



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 8 Mars 2023

Nr: 149

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË PËRMET, PËR
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 8 Mars 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Denisa Durro, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Përmet

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 27.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkisë Përmet.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

Data: 8 Mars 2023

Nr: 149
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike”

"MBILL DASHURI! Data e kuqe në kalendarin e muajit shkurt shënon ditën e dashurisë dhe zemrave plot."

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=498309602491035&set=pcb.498309782491017>

Theksohet se aktiviteti public nuk është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Më datë 27.2.2023, bashkisë Përmet i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike

Më datë 1.3.2023, bashkia Përmet bën me dije se: Përsa i përket aktivitetit sipas email-it të dhënat janë si me poshtë: Aktiviteti është zhvilluar si më poshtë "Data: 14.2.2023, Ora: 10.00, Organizatori: Këshilli Rinor, Tematika e aktivitetit: "Mbill Dashuri" me rastin e ditës së Shën Valentinit, Pjesëmarrës: Anëtarë të Këshillit Rinor dhe të rinj të qytetit të Përmetit, Mediatizimi: Nuk ka patur media të pranishme".

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se bashkia Përmet, referuar nenit 92, pika 3 të Kodit Zgjedhor, nuk ka pasur detyrimin për raportim të veprimtarisë publike së mësipërme, pasi nuk ka qenë institucioni organizator i veprimtarisë publike, por ka qenë në cilësinë e të ftuarit.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se objekti rast denoncimi, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Data: 8 Mars 2023

Nr: 149
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike"

vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Denisa Durro person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Përmet.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 8 Mars 2023

Nr: 149
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Përmet, për raportimin e veprimtarive publike”